



Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN GRUPI I PUNËS PËR KAPITULLIN 24: Drejtësia, Liria, Siguria

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe praktikat më të mira për funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ARO)

25 mars 2026, 09:00 – 12:00

Ngritja e kapaciteteve për ARO dhe bashkëpunimi

- Zyra e Rikuperimit të Aseteve (ARO) është një strukturë e re e krijuar së fundi në Shqipëri si kërkesë e procesit të përafrimit të legjislacionit me BE dhe standardet për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në kuadër të Kapitullit 24.
 - Në këtë drejtim është me rëndësi që për këtë strukturë të ketë një përshkrim të qartë të punës, procedurave dhe standardeve që duhet të realizohen, duke garantuar funksionim të unifikuar dhe operacional.
 - Është e rëndësishme që organizimi i brendshëm i ARO të përcaktohet përmes akteve nënligjore dhe rregulloreve të brendshme institucionale, duke siguruar fleksibilitet operacional dhe koordinim të qartë ndër-institucional.
 - ARO mund të ketë kapacitete të kufizuara, por shumë të specializuara (strukturë e vogël dhe e fokusuar), të mbështetur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.
- Rekomandohet të ketë një planifikim të saktë dhe të qartë të buxhetimit për ngritjen e kapaciteteve të kësaj zyre, i cili duhet të përfshijë parashikimin e stafit dhe nevojave operationale, si dhe programe të dedikuara trajnimi me fokus:
 - rritjen e aftësive dixhitale dhe përdorimin e databazave të specializuara
 - njohjen e procedurave, standardeve dhe kuadrit ligjor të BE-së në fushën e rikuperimit të asetëve
 - forcimin e kapaciteteve gjuhësore (veçanërisht anglishtja) për bashkëpunim ndërkombëtar efektiv dhe në kohë reale

**Ky sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Bazat: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – Instrumenti i Shoqërisë Civile IPA 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Shoqatën Sllovaqe të Politikës së Jashtme (SPPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Liri Informacioni (CTFI)*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



- Momentalisht ARO nuk ka kompetenca hetimore, por me Direktivën e re të BE-së 2024/1260, e cila pritet të transpozohet, parashikohet zgjerim i funksioneve, përfshirë mundësinë për masa administrative të ruajtjes së aseteve (jo konfiskim klasik), duke krijuar hapësirë për ndërhyrje të shpejtë dhe njoftim të autoriteteve të drejtësisë. Në këtë drejtim, rekomandohet që këto risi të pasqyrohen në kuadrin ligjor dhe procedural të ARO në Shqipëri.
- Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit:
 - me institucionet e drejtësisë dhe strukturat e posaçme (SPAK), gjykatat dhe prokuroritë, si dhe me agjencitë fiskale dhe të informacionit
 - me zyrat homologe europiane dhe rajonale përmes shkëmbimit të shpejtë dhe të strukturuar të informacionit
 - me Agjencinë e Inteligjencës Financiare dhe agjencinë për menaxhimin e pasurive të sekuestruara, duke synuar sinergji institucionale
 - me sektorin privat dhe bankar për akses të shpejtë në informacion financiar dhe gjurmim të aseteve me platforma dhe kompani ndërkombëtare teknologjike për akses në të dhëna relevante (p.sh. platforma digjitale dhe shërbime online)
- Nga eksperiencia e vendeve të BE-së, vonesat në shkëmbimin e informacionit janë një problem i përsëritur. Për këtë rekomandohet:
 - vendosja e afateve ligjore të detyrueshme për kthimin e informacionit
 - përcaktimi i procedurave urgjente për raste me rrezik të lartë
 - parashikimi i mekanizmave ndëshkues për mosbashkëpunim ose vonesa të pajustificuara
- Sugjerohet që përfaqësuesit e ARO në Shqipëri të jenë pjesë e rrjetit dhe databazës së ARO-ve të BE-së, duke mundësuar identifikim të shpejtë të kontakteve homologe dhe komunikim të drejtpërdrejtë operacional në raste urgjente. Rekomandohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja aktive në rrjetin europian të ARO-ve, si dhe përdorimi i platformave të sigurt të komunikimit ndër-institucional për shkëmbim informacioni në kohë reale.



Financuar nga
Bashkimi Evropian



- Nga eksperiencia sllovaqe evidentohet rritja e vazhdueshme e kërkesave për informacion brenda BE-së, çka kërkon që ARO në Shqipëri të ndërtojë kapacitete të mjaftueshme për përpunim të shpejtë dhe efikas të kërkesave. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të ARO është thelbësor dhe duhet të përfshijë:
 - përdorimin e sistemeve të informacionit dhe databazave
 - hetimin financiar dhe gjurmimin e aseteve
 - bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar
 - përdorimin e platformave të komunikimit të sigurt
- Trajnimet duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura me zhvillimet e reja ligjore të BE-së, përfshirë Direktivën e re për rikuperimin e aseteve. Si dhe rekomandohet pjesëmarrja e rregullt në programe ndërkombëtare trajnimi dhe shkëmbimi eksperiencash me vendet e BE-së.

Informimi dhe ndërgjegjësimi, përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë

- Duke qenë një strukturë e re dhe në kontekst të ndryshimeve të Direktivës së BE-së 2024/1260, rekomandohet realizimi i një fushate të strukturuar informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rolin, funksionin dhe detyrimet e ARO, si dhe mbi përgjegjësitë e institucioneve të tjera në zinxhirin e bashkëpunimit.
 - Këto fushata mund të realizohen në bashkëpunim me shoqërinë civile, akademinë dhe ekspertët e fushave relevante (krimi i organizuar, krimi financiar, pastrimi i parave dhe krimi kibernetik), duke synuar: institucionet publike dhe të drejtësisë, sektorin financiar dhe bankar, biznesin dhe aktorët ekonomikë, median dhe gazetarët si aktorë të informimit publik, qytetarët dhe grupet e interesit.